


ANGAZHIMI YNË NË SHOQËRI



DUKE SHKUAR DREJT TË ARDHMES

ANDI (13), FESTIM (13), EDONIS (14), ANITA (13), FLORENTINA (14), SYARTA (13), ELONA (13)




Ne, nxënësit e klasës VIII-7 të shkollës „Zenel Hajdini“ nga Prishtina kemi të drejta të barabarta dhe respektojmë njëri-tjetrin. Në këtë artikull ne dëshirojmë t’iu flasim për këtë dhe për demokracinë në vendin tonë

Fillimisht ne diskutuam për prejardhjen e fjalës demokraci. Fjala demokraci rrjedh nga fjala greke „demos“ që do të thotë popull, dhe fjala „kratia“ që do të thotë rend apo qeverisje. Kjo do të thotë se demokracia është qeverisje e popullit. Populli jemi ne, qytetarët. Demokracia për herë të parë është shfaqur në vitin 507 para erës sonë, në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë. Në atë kohë demokracia kishte formën e demokracisë së drejtpërdrejtë. Në demokracinë e drejtpërdrejtë populli i merr vendimet aty për aty. Por, në vendimmarrje nuk merrnin pjesë gratë e as të varfërit. Më vonë u përhap forma e dytë e demokracisë, e cila është demokracia përfaqësuese. Në këtë formë demokratike, vendimet

merren përmes përfaqësuesve të popullit. Kjo do të thotë se ne qytetarët e vendit dalim në zgjedhje dhe votojmë për kënd dëshirojmë të na udhëheq dhe të marrë vendime për neve, popullin. Edhe Kosova, si shtet demokratik punon sipas parimeve të demokracisë përfaqësuese, ku mbizotëron sistemi parlamentar. Sistemi tjetër i demokracisë përfaqësuese është sistemi presidencial, ku qytetarët e atij vendi votojnë për Presidentin/en e vendit. Në Kosovë, sipas sistemit parlamentar, qytetarët e saj votojnë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë. Detyra kryesore e deputetëve të Kuvendit është miratimi i ligjeve të vendit tonë. Këtë ata e bëjnë përmes votimit. Por, si bëhet votimi në Kuvend? Deputetët mund të pranojnë, kundërshtojnë apo abstenojnë për ligje të caktuara. Është përgjegjësi e deputetëve të votojnë ligjet të cilat janë më të mirat për të gjithë qytetarët e Kosovës, sepse ata na përfaqësojnë neve, qytetarëve.



Ne, gjatë punës së përbashkët



Eja, voto edhe ti!

Në këtë pjesë të artikullit ne kemi paraqitur njohuri dhe fakte për qytetarinë aktive, të cilat i kemi marrë gjatë punëtorisë së demokracisë

Sipas bisedës tonë, ne mësuam se qytetarë janë të gjithë personat të cilët jetojnë në territorin e një vendi. Qytetarët kanë përgjegjësi ndaj demokracisë. Ata nuk jetojnë vetëm në qytet, por jetojnë edhe në fshatra. Edhe nëse shkojmë në Itali, jetojmë 2 apo 3 vite, ne nuk jemi qytetarë të Italisë, por akoma jemi qytetarë të Kosovës sepse emri ynë dhe të dhënat tona nuk janë të regjistruara në shtetin e Italisë, por në Kosovë. Qytetarët e Kosovës kanë shumë të drejta. Disa nga ato janë: e drejta e punësimit, e drejta e mjekimit, e drejta e shkollës, e drejta e argëtimit, e drejta e strehimit, e drejta e ushqimit, e drejta e emrit etj. Kurse, ne qytetarët kemi shumë përgjegjësi. Ne duhet të mësojmë, të mos thyejmë gjëra në shkollë, të mbajmë ambientin pastër, të votojmë për kandidatin më të mirë, si dhe të punojmë që të zhvillojmë sa më shumë demokracinë e popullit tonë. Pra, ju ftojmë ta mbrojmë demokracinë.



Gazetarët e këtij artikulli



Mendimet tona rreth demokracisë



Pëllumbi i paqes



Ne meritojmë paqe

Të drejtat	Përgjegjësitë
<ul style="list-style-type: none"> • E drejta e lojës • E drejta e shprehjes • E drejta e strehimit • E drejta për pjesëmarrje • E drejta e mjekimit • E drejta e punës 	<ul style="list-style-type: none"> • Respektimi i funksionit dhe objekteve • Kujdesja e detajuar dhe kujdesi për objektet shkollë • Rregullt e rregullit dhe pastërtia në ambient • Të mos shkaktoj trazira të mëdha • Sterilizimi i mjeteve të punës • Respektimi i orarit të punës dhe respektimi i rregullorës.

Të drejtat dhe përgjegjësitë tona

NJË VENDIM PËR TË GJITHË

BATON (13), MELISA (13), FATLINDA (13), FILLESA (13), TRINGA (13), ELSA I. (13), ALTIN (13)



Në këtë artikull mund të mësoni se si funksionon një vend demokratik

Secili prej nesh ka një mendim, një mënyrë se si e dëshiron të jetoj jetën e tij, dhe këto mundësohen në një vend demokratik.


Një institucion mjaft i rëndësishëm që ndikon në të tashmen dhe të ardhmen tonë është Kuvendi.

Në Kuvend gjenden përfaqësuesit tanë, më saktësisht personat të cilët populli i zgjedh. Secili shtet demokratik me sistem parlamentar ka përfaqësuesit (deputetët) e tij, të cilët marrin vendime në Kuvend. Këta deputetë votohen në proceset zgjedhore nga populli. Në Kuvend marrin pjesë 120 deputetë, ku 100 vende janë të garantuara për deputetë nga kombi shqiptarë, kurse 20 të tjera janë për komunitetet jo shumicë (serbë, romë, ashkali, egjiptianë, turq dhe boshnjak).

Kuvendi ynë përveç funksionit përfaqësues, ka edhe funksion kontrollues dhe legjislativ. Ka funksion kontrollues sepse mbikëqyr Qeverinë, kurse ka funksion legjislativ sepse merret me miratimin e ligjeve.

Në Kuvend punët ndahen në grupe punuese, të cilat ndryshe quhen komisione parlamentare. Nëse Ministria e Shëndetësisë propozon një ligj, atëherë Komisioni për Shëndetësi shqyrton projektligjin para se të votohet në Kuvend.

Ligjet janë rregulla të cilat duhen të respektohen dhe të zbatohen. Edhe pse kemi mjaft liri dhe të drejta të barabarta, ne si qytetarë prapë se prapë duhet t'i re-



Respekto ligjet

pektojmë ligjet.

Janë disa gjëra që neve na bëjnë të mos mendojmë vetëm për veten tonë, por të kemi bashkëpunim dhe respekt me të tjerët.

Duke u kujdesur për njëri-tjetrin fitojmë respekt, dhe gjithashtu tregojmë se si përmbushen përgjegjësitë e një qytetari të mirë.

Kosova është një vend demokratik, prandaj ne kemi lirinë e shprehjes dhe duhet të bashkëpunojmë për një të ardhme sa më të mirë.



Autorët e këtij artikulli

ZGJEDH MË TË MIRËN

ARDIT (13), ANIKA (13), ERONA (13), EURONA (13), ELSA (13), LEJLA (13), VLORIAN (13)



Zgjedhjet janë themeli i demokracisë

A keni qenë ndonjëherë në dilemën kur ju duhet të zgjedhni midis dy gjërave (opsioneve), e ku domosdoshmërisht duhet të zgjedhni njërën? Vetëm atëherë mund ta kuptoni rëndësinë dhe vlerën që zgjedhjet kanë. Një zgjedhje e jona mund të ndryshoj rrugëtimin e jetës sonë.

Pavarësisht se në çfarë situate ndodhemi, të gjitha zgjedhjet që ne i bëjmë për veten tonë duhet që gjithmonë të jenë në favorin tonë. Por, pse duhet të jenë në favorin tonë mund të pyet dikush? Sepse secili nga ne meriton të trajtohet i dashur dhe i barabartë me të tjerët, e në mënyrë që të trajtohem të fillë ne së pari duhet të kemi respekt për veten tonë. Këto janë edhe disa nga shtyllat e demokracisë, që përveç të tjerash janë edhe zgjedhjet e lira edhe të barabarta, respektimi i komuniteteve jo shumicë, sundi-

mi i ligjit, etj.

Kur flasim për zgjedhjet e lira dhe të barabarta, kuptojmë atë që ne jemi të lirë të votojmë për atë që ne mendojmë që është më i miri dhe që do t'i shërbejnë popullit denjësisht, sepse njerëzit që ne i zgjedhim na përfaqësojnë neve dhe interesat tona.

Në Kosovën tonë kemi dy lloje zgjedhjesh: zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore.

Në zgjedhjet lokale, qytetarët i votojnë kandidatët të cilët shpallin kandidaturën e tyre për kryetar të komunës ose asambleistë, ndërsa në zgjedhjet qendrore qytetarët i votojnë të gjithë ata të cilët kandidojnë për deputet.

Për të pasur të drejtë kandidimi, të gjithë kandidatët duhet të jenë mbi moshën 18 vjeçare.

Mos harro! Çdo herë në jetë zgjedh atë që të duket e drejtë, sepse zgjedhja të përket ty!



Një zgjedhje e përditshmërisë sonë



Autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Zenel Hajdini“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-7
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë